

Hyundai Auto Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e vetëm të Shoqërisë Hyundai Auto Albania sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Hyundai Auto Albania sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

18 qershor 2018



Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

 **MAZARS**
Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	11,120,123	14,925,067
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	418,586,257	19,296,037
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	37,271,184	32,520,104
Parapagime per furnizime	7	131,589,215	309,609,792
Inventarë	8	203,805,453	179,669,878
Totali i aktiveve afatshkurtra		802,372,232	556,020,878
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	82,591,514	82,713,762
Totali i aktiveve afatgjata		82,591,514	82,713,762
Totali i aktiveve		884,963,746	638,734,640
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	367,565,244	214,406,487
Llogari të pagueshme tregtare	11	110,563,020	117,347,697
Detyrime tatimore	12	8,486,656	4,330,198
Të ardhurat e shtyra	13	11,766,333	3,718,825
Të tjera detyrime	14	24,233,218	16,345,075
Totali i detyrimeve afatshkurtra		522,614,471	356,148,282
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	10	184,353,841	156,287,921
Totali i detyrimeve afatgjata		184,353,841	156,287,921
Totali i detyrimeve		706,968,312	512,436,203
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	15	100,000	100,000
Rezerva të tjera		8,212,168	5,159,318
Fitime të mbartura		117,986,269	59,982,125
Fitimi i ushtrimit		51,696,997	61,056,994
Totali i kapitalit		177,995,434	126,298,437
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		884,963,746	638,734,640

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	2,857,014,807	2,185,966,229
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	3,520,424	3,023,565
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime		(2,719,365,666)	(2,073,272,399)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	18	(2,669,173,683)	(2,039,644,610)
2) Të tjera shpenzime	19	(50,191,983)	(33,627,789)
Shpenzime të personelit	20	(19,445,230)	(15,924,585)
1) Paga dhe shpërblime		(16,931,294)	(13,828,960)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/ shëndetësore		(2,513,936)	(2,095,625)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(17,787,852)	(9,193,439)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(4,003,674)	(178,642)
Shpenzime financiare	22	(33,067,976)	(15,158,401)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(33,067,976)	(15,158,401)
Fitimi/humbja para tatimit		66,864,833	75,262,328
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(15,167,836)	(14,205,334)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	23	(15,167,836)	(14,205,334)
Fitimi/humbja e vitit		51,696,997	61,056,994
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		51,696,997	61,056,994

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Hyundai Auto Albania sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	100,000	2,709,186	13,429,587	49,002,670	65,241,443
Transferimi në fitime të mbartura					-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:			46,552,538	(46,552,538)	-
Transferimi në rezerva ligjore		2,450,132		61,056,994	61,056,994
				(2,450,132)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	100,000	5,159,318	59,982,125	61,056,994	126,298,437
Transferimi në fitime të mbartura					-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:			58,004,144	(58,004,144)	-
Transferimi në rezerva ligjore		3,052,850		51,696,997	51,696,997
				(3,052,850)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	100,000	8,212,168	117,986,269	51,696,997	177,995,434

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i Hyundai Auto Albania sh.p.k më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:

Ilir Zeka
Administrator

Teuta Jorgo
Financiere

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	66,864,833	75,262,328
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	(15,167,836)	(14,205,334)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	17,787,852	9,193,439
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	902,752	(729,521)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(226,020,723)	(84,312,619)
Rënie/(rritje) në inventarë	(24,135,577)	(103,798,516)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	13,307,432	(2,808,432)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(166,461,267)	(121,398,655)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(34,384,059)	(75,108,772)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	15,815,705	21,888,147
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(18,568,354)	(53,220,625)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	181,224,677	186,786,508
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	181,224,677	186,786,508
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(3,804,944)	12,167,228
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	14,925,067	2,757,839
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	11,120,123	14,925,067

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Hyundai Auto Albania Shpk është krijuar në vitin 2006, me vendim gjykatë Nr. 36760, datë 04.12.2006.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria Hyundai Auto Albania Shpk është shoqëri shqiptare. Ortak i vetëm është z. Ilir Zeka që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali i Shoqërisë është 100,000 lekë. Administrator i Shoqërisë nga data 19.07.2011 deri më 19.07.2019 është emëruar z. Ilir Zeka.

Selia e Shoqërisë ndodhet tek Autostrada Tiranë-Durrës, Kilometri 1, Godinë 4 kate, Kashar, Tiranë. Shoqëria është regjistruar me NIPT K62420006T.

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është import automjetesh, shërbim riparimi të tyre, servis universal. Në 31 dhjetor 2017 Shoqëria ka 19 punonjës (2016: 15).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë në raportuar të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)****2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar, të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në ç'regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit të cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshim në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale, me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
EUR/LEK	132.95	135.23
USD/LEK	111.10	128.17

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë kostot e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar, duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes, duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeletar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve, në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e ç'montimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material, duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortiz në %		Metoda e llogaritjes
	2017	2016	
Toka	0	0	
Ndërtime e instalime	5	5	
Makineri e Pajisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	Mbi vlerën e mbetur të AAM-ve
Pajisje zyre	20	20	
Pajisje kompiuterike	25	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	20	

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritjeje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit, përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin e pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme, që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës, sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare, por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Depozita në bankë e llogari të tjera	9,979,591	13,846,693
Depozita garancie në bankë	833,250	840,090
Vlera në arkë	307,282	238,284
	<u>11,120,123</u>	<u>14,925,067</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë për mallra, produkte dhe shërbime	418,586,257	19,296,037
	<u>418,586,257</u>	<u>19,296,037</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime palë të lidhura	19,184,228	19,910,087
Shteti Tatime dhe Taksa - Tatim Fitimi	788,648	9,936,628
Shteti Tatime dhe Taksa - Tatim në Burim	95,372	95,372
Paradhënie për punonjësit	1,396,843	1,811,433
Të tjera kërkesa	13,682,227	522,664
Llogari ne pritje	2,123,866	243,920
	<u>37,271,184</u>	<u>32,520,104</u>

7. Parapagime për furnizime

Parapagime për furnizime detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime për mallra, produkte, shërbime	131,589,215	309,609,792
	<u>131,589,215</u>	<u>309,609,792</u>

Hyundai Auto Albania sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Inventar i imët	1,563,664	1,389,434
Mallra Grupi I	202,241,789	178,280,444
	<u>203,805,453</u>	<u>179,669,878</u>

9. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe paisje	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2016	5,130,820	4,814,036	32,299,918	6,801,478	49,046,252
Shtesa	-	322,829	71,359,227	3,426,716	75,108,772
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(23,401,545)	-	(23,401,545)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	5,130,820	5,136,865	80,257,600	10,228,194	100,753,479
Shtesa		24,729	30,574,606	3,784,724	34,384,059
Nxjerrje jashtë përdorimit			(22,701,409)	-	(22,701,409)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	5,130,820	5,161,594	88,130,797	14,012,918	112,436,129
Zhvlërësimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2016	731,783	2,993,856	2,378,156	4,985,402	11,089,197
Amortizimi i vitit	219,952	363,241	8,180,901	429,345	9,193,439
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(2,242,919)	-	(2,242,919)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	951,735	3,357,097	8,316,138	5,414,747	18,039,717
Amortizimi i vitit	208,954	334,278	15,700,877	1,543,743	17,787,852
Nxjerrje jashtë përdorimit			(5,982,954)		(5,982,954)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,160,689	3,691,375	18,034,061	6,958,490	29,844,615
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2016	4,179,085	1,779,768	71,941,462	4,813,447	82,713,762
Gjendja më 31 dhjetor 2017	3,970,131	1,470,219	70,096,736	7,054,428	82,591,514

Hyundai Auto Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

10. Huatë

Huatë më 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

Huadhënesi	Lloji Huase	Data e marrjes	Data e Shlyerjes	Afati	Monedha	Shuma e			Shuma për t'u shlyer deri		
						principal	Balanca e Mbetur				
						EUR	EUR	ALL	në 1 vit	mbi 1 vit	
Nga Bankat											
Intesa San Paolo	OVD	27.06.2017	26.06.2018	1 Vit	EUR	300,000	298,204	39,646,254	39,646,254	-	-
							298,204	39,646,254	39,646,254	-	-
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	01.03.2016	31.08.2019	42 muaj	EUR	170,591	3,657	486,178	385,502	100,676	
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	16.02.2017	15.07.2020	42 muaj	EUR	524,413	18,026	2,396,537	880,416	1,516,121	
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	06.09.2017	05.04.2021	42 muaj	EUR	537,315	221,906	29,502,372	9,173,970	20,328,402	
Raiffeisen Leasing	Leasing	14.11.2017	13.11.2020	36 muaj	EUR	17,837	13,849	1,841,230	345,391	1,495,839	
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	24.11.2017	23.05.2021	42 muaj	EUR	189,237	71,718	9,534,961	1,191,539	8,343,422	
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	15.12.2017	14.06.2021	42 muaj	EUR	80,625	80,625	10,719,094	14,930	10,704,164	
							409,781	54,480,372	11,991,748	42,488,624	
NBG	OVD	04.04.2017	03.04.2018	1 Vit	EUR	250,000	248,616	33,053,460	33,053,460	-	-
							248,616	33,053,460	33,053,460	-	-
Procredit Bank	OVD	24.05.2017	23.05.2018	1 Vit	EUR	150,000	145,871	19,393,579	19,393,579	-	-
							145,871	19,393,579	19,393,579	-	-
Societe Generale	Kredi Leasing	21.10.2015	20.10.2020	5 vjet	EUR	49,500	23,929	3,181,306	1,225,266	1,956,040	
Societe Generale	OVD			1 Vit	EUR	100,000	98,556	13,103,075	13,103,075	-	-
Societe Generale	OVD	29.11.2017	29.01.2018	9 muaj	EUR	300,000	303,426	40,340,528	40,340,528	-	-
							425,911	56,624,909	54,668,868	1,956,040	
Banka Credins	Leasing	10.10.2016	10.10.2019	3 Vjet	EUR	266,400	131,457	17,477,191	8,601,759	8,875,432	
Banka Credins	Leasing	24.10.2016	10.10.2019	3 Vjet	EUR	52,320	27,644	3,675,262	1,684,570	1,990,692	
Banka Credins	Financim stoku	22.12.2016	10.12.2019	3 Vjet	EUR	173,485	14,945	1,986,996	431,423	1,555,573	
Banka Credins	Financim stoku	13.06.2017	12.06.2020	3 Vjet	EUR	356,870	11,641	1,547,716	1,547,716	-	-
Banka Credins	Leasing	22.06.2017	21.06.2020	3 Vjet	EUR	10,000	6,772	900,383	900,383	-	-
Banka Credins	Financim stoku	21.06.2017	20.06.2020	3 Vjet	EUR	105,932	50,526	6,717,485	3,591,767	3,125,718	
Banka Credins	Leasing	19.09.2017	20.09.2020	3 Vjet	EUR	32,500	24,021	3,193,620	1,096,012	2,097,608	
Banka Credins	Leasing	28.09.2017	27.09.2020	3 Vjet	EUR	21,833	16,137	2,145,453	736,306	1,409,146	

Hyundai Auto Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

Huadhënesi	Lloji Huase	Data e		Afati	Monedha	Shuma e principal		Balanca e Mbetur		Shuma për t'u shlyer deri	
		marrjes	Shlyerjes			EUR	EUR	EUR	ALL	në 1 vit	mbi 1 vit
Banka Credins	Financim stoku	29.09.2017	28.09.2020	3 Vjet	EUR	112,903	60,584	8,054,668	3,895,973	4,158,695	
Banka Credins	Leasing	26.10.2017	25.10.2020	3 Vjet	EUR	19,083	14,494	1,926,996	640,096	1,286,900	
Banka Credins	Leasing	02.11.2017	01.11.2020	3 Vjet	EUR	23,333	18,196	2,419,113	778,422	1,640,691	
Banka Credins	Leasing	03.11.2017	02.11.2020	3 Vjet	EUR	42,333	33,012	4,388,963	1,412,295	2,976,668	
Banka Credins	Leasing	14.11.2017	13.11.2020	3 Vjet	EUR	10,000	7,798	1,036,763	333,611	703,151	
Banka Credins	Financim stoku	27.12.2017	26.12.2020	3 Vjet	EUR	16,000	16,000	2,127,200	473,068	1,654,132	
Banka Credins	Financim stoku	29.12.2017	28.12.2020	3 Vjet	EUR	41,410	32,484	4,318,769	1,007,152	3,311,617	
							465,713	61,916,577	27,130,552	34,786,024	
Albanian Financial Institution	Financim stoku	03.04.2017	02.04.2020	3 vjet	EUR	321,203	70,370	9,355,668	1,948,856	7,406,811	
Albanian Financial Institution	Financim stoku	01.11.2017	31.10.2020	3 vjet	EUR	356,218	220,094	29,261,436	4,424,022	24,837,415	
Albanian Financial Institution	Faktoring	06.12.2017	15.02.2018		LEK			74,000,000	74,000,000	-	
							290,464	112,617,104	80,372,878	32,244,226	
Hua nga BKT me Classic shpk	Kredi	16.12.2016	16.12.2019	3 Vjet	EUR	600,000	400,000	53,179,996	26,590,005	26,589,991	
L/C nga BKT me Classic shpk	Kredi				EUR	485,000	61,000	8,109,950	8,109,950	-	
							461,000	61,289,946	34,699,955	26,589,991	
Classic S & J	Kredi	11.03.2016	11.03.2017	1 Vit	EUR	686,000	348,168	46,288,936	-	46,288,936	
							348,168	46,288,936	-	46,288,936	
Tirana Factoring & Lease	Financim Stok	27.07.2016	27.07.2017	1 Vit	EUR	250,000	250,000	33,237,500	33,237,500	-	
							250,000	33,237,500	33,237,500	-	
Indrit Bardho	Kredi	23.12.2016	23.12.2017	1 Vit	EUR	316,000	251,000	33,370,450	33,370,450	-	
							251,000	33,370,450	33,370,450	-	
							3,594,728	551,919,085	367,565,244	184,353,841	

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime	110,563,020	117,347,697
	110,563,020	117,347,697

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Sigurimet shoqërore	389,227	303,219
TVSH për tu paguar	8,218,629	3,907,711
Tatimi mbi të ardhurat personale të punonjësve	234,465	102,318
Detyrime doganore	(355,665)	16,950
	8,486,656	4,330,198

13. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Parapagime të marra për blerje makinash	11,766,333	3,718,825
	11,766,333	3,718,825

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Zyra e Shërbimit Përmbarimor (Autoriteti Konkurrencës)	5,090,660	5,150,660
Të tjera detyrime Ortaku	19,082,559	11,194,415
Paga e shperblime	59,999	-
	24,233,218	16,345,075

15. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100,000 LEK, i zotëruar 100% nga ortaku i vetëm Ilir Zeka. Kapitali më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Ilir Zeka	100	1,000	100%	100	1,000	100%
	100	1,000	100%	100	1,000	100%

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2017 në vlerën 51,696,997 LEK (2016: 61,056,994 LEK).

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Nga shitje automjesh	2,757,391,841	2,117,287,875
Kryerja e shërbimeve (Servis automjesh)	5,995,815	5,889,393
Nga shitja e pjesëve të këmbimit për automjete	62,547,645	50,800,399
Dhënie automjesh me qera	31,079,506	11,988,562
	2,857,014,807	2,185,966,229

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	31 dhjetor 2017
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	2,881,037,186
Zbriten Autofaturimet 2016	(26,308)
Zbriten parapagimet në çelje	3,718,825
Shtohet parapagimet në mbyllje	(11,766,333)
Zbriten të ardhura nga shitja e aktiveve paraqitur neto	(16,718,457)
Te ardhura nga rivleresimet	4,290,318
Shuma e qarkullimit të korrigjuar	2,860,535,231
Sipas Kontabilitetit	2,860,535,231
Diferenca	-

17. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe rezultatit nga shitja e AAM-ve, të cilat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	15,815,705	21,888,147
Vlera e mbetur e AAM-ve të shitura	(16,718,457)	(21,158,626)
Diferencat pozitive nga Këmbimi	135,747	1,873,010
Fitim nga këmbimet valutore	4,287,429	421,034
	3,520,424	3,023,565

18. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Blerje mallra/pjese kembimi	2,595,491,383	1,979,693,843
Qira ndërtese e automjete	10,726,409	11,075,292
Takse doganore dhe skanimi	4,085,589	3,751,982
Transport në blerje për pjesë dhe makina	36,879,758	33,127,249
Shpenzime për karburant	290,205	237,571
Shpenzime për agjensi doganore	2,942,209	2,430,579
Shpenzime riparimi e rregjistrimi automjete	4,932,396	2,106,422
Shpenzime për marrje makina me qera	182,001	256,841
Rregjistrim automjete	8,320,734	1,109,976
Update i kontrollit dhe servisit makina	224,677	797,490
Sigurim mjete dhe TPL	4,422,402	5,057,365
Akciza	2,920	-
Taksa vendore	673,000	-
	2,669,173,683	2,039,644,610

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Taksa e tarifa vendore	-	401,000
Telefoni, internet e DHL	329,879	292,462
Komisione bankare	5,071,236	4,625,324
Shpenzime udhëtimi e dieta	807,309	1,528,380
Shpenzime për kontrata me bankat	-	-
Shpenzime për roje private	3,193,133	3,166,710
Personel nga jashtë, konsulence e honorare	816,667	320,000
Shpenzime për energji	1,101,160	1,166,144
Shpenzime përfaqësimi e pritje përcjellje, reklama	6,506,852	1,659,266
Shpenz. noterizimi, përmbarimi, gjyqësore e siguracione	1,579,276	1,164,839
Shpenzime për kanceleri e dokumenta	435,706	301,705
Shpenzime për mirëmbajtje ambjenti, trajtim punonjësve	519,447	349,300
Shpenzime të ndryshme	1,723,268	2,031,883
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullta	23,018,894	9,117,178
Shpenzime për mbyllje parakohe të kontratës shitje makine	879,162	182,296
Sigurim garancie malli	398,220	119,248
Shpenzime pa fatura	3,811,774	7,202,054
	50,191,983	33,627,789

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	16,931,294	13,828,960
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,513,936	2,095,625
	<u>19,445,230</u>	<u>15,924,585</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 19 (2016: 15).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Gjopa dhe dëmshpërblime	4,003,674	178,642
	<u>4,003,674</u>	<u>178,642</u>

22. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për interesa	(33,178,390)	(15,161,387)
Të ardhura nga interesat	110,414	2,986
	<u>(33,067,976)</u>	<u>(15,158,401)</u>

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Fitimi para tatimit</i>	66,864,833	75,262,328
Total shpenzime të panjohura	34,254,075	19,439,897
Gjoha dhe penalitete	4,003,674	178,642
Shpenzime me fatura jo të rregullta tatimore	3,811,774	7,265,039
Shpenzim për regjistrim mjeti pa faturë	1,148,514	848,892
Shpenzime për mbyllje parakohore të kontr. Shitjes makinës	879,162	186,054
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullta	23,018,894	9,117,178
Shpenzime për interesa të panjohura	493,000	1,184,207
Shpenzime të tjera	899,057	659,885
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	101,118,908	94,702,225
<i>Tatim fitimi @15%</i>	15,167,836	14,205,334
	51,696,997	61,056,994

24. Angazhime dhe pasiguri

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Mazars

Address

Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5

Tirane, Shqiperi

Tel. +355 (0) 42 278 015

audit@mazars.al

www.mazars.al



MAZARS